

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Mr.sc Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Xh.B., nga Prishtina, kundër të paditurës P.T.K., sh.a. në Prishtinë, për kompensimin e diferencës së pagës, lidhur me revizionin e së paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1497/2015, datë 12.1.2016, në seancën e mbajtur më 15 prill 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i së paditurës P.T.K., me seli në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1497/2015, datë 12.1.2016, përkitazi me pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me anulimin e aktvendimit të s; paditurës nr.01.1040-785/2012 të datës 7.3.2012, me të cilin paditësit i është ulur ka grada nga 7 në 6.

Revizioni i së paditurës pranohet si i bazuar përkitazi me pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me pagimin e ndryshimi të pagës ndërmjet gradës 7 dhe 6 dhe, lidhur me këtë pjesë, prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1497/2015, datë 12.1.2016 dhe ai i Gjykatës Themelore Prishtinë, C.nr.1219/2012, datë 30.1.2015, kurse lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 1497/2015, datë 12.1.2016, është ndryshuar pjesa aprovuese e aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë,

C.nr.1219/2012, datë 30.1.2015, vetëm sa i përket kamatës mbi shumën e aprovuar, ashtu që mbi këtë shumë paditësit i caktohet kamata të cilën e paguajnë bankat afariste për mjetet e depozituara në bankë mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 1.2.2012 gjer në pagesën përfundimtare, kurse sa i përket pjesës tjetër, ankesa e së paditurës është refuzuar si e pabazuar dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë, C.nr.1219/2012, datë 20.1.2015, është vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë e paditura ka paraqitur revizion brenda afatit ligjor, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimet e të dy gjykatave të ndryshohen dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet apo ato të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të nenit 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni i së paditurës është pjesërisht i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, në bazë të kontratës së punës nr. 01-2880-2944/2011, datë 20.10.2011, me cilësi të punëmarrësit, ka themeluar marrëdhënie pune tek e paditura në detyrat e punës teknik specialist, në njësinë -T.K., Në nenin 5 të kësaj kontrate parashikohet që paditësit puna e kryer t'i kompensohet me pagë të përcaktuar me gradën e 7-të, sipas vendimit të Bordit të përkohshëm të drejtorëve të PTK-ës, nr.01-1630/2005, datë 28.2.2005, së paku një herë në muaj, e cila nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale.

Kryeshefi i PTK-ës, duke u bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve të datës 13.12.2011, me aktvendimin nr.01.1040-785/2012 të datës 7.3.2012, i ka ulur paditësit gradën prej 7 në 6. Kundër aktvendimit të sipërpërmendur, paditësi ka ushtruar ankesë, por përgjigje nuk ka marrë.

Bordi i Drejtorëve i së paditurës e bazon vendimin e saj në rekomandimin e aksionarit të PTK-ës - Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrisë për Zhvillim Ekonomik për reduktimin e shpenzimeve operative për personelin e së paditurës.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave, ka gjetur se, neni 5 i kontratës së punës, lidhur mes paditësit dhe së paditurës, nuk është në pajtim me aktvendimin mbi ndryshimin e pagës së paditësit dhe, duke u bazuar në nenin 55 të Ligjit të Punës, e ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që e ka anuluar aktvendimin e të paditurës ..., datë ... dhe e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguajë ndryshimin e bonusit dhe trustit mes gradës 7 dhe 6 për çdo muaj, duke filluar nga data 1.2.2012, me kamatë 4% deri në përmbushjen definitive të detyrimit. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës -Ministrisë për Zhvillim Ekonomik nuk ka qenë ulja e pagave të punëtorëve, por ulja e shpenzimeve operative për personelin e së paditurës në raport me të hyrat e përgjithshme të PTK-ës, prandaj e ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar në procedurën ankimore, e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me kamatën, ndërsa në pjesët e tjera, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, i ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur e ka pranuar si të pabazuar padinë e paditësit.

Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta të tilla që do të ndikonin në ligjshmërinë e tij. Sikurse të dy gjykatat e instancave më të ulëta, edhe kjo Gjykatë mendon se paditësit i takon e drejta e pagës e cila i caktohet të punësuarit me kontratë të punës në pajtim me

Ligjin e Punës, me kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditësit, sipas kontratës së punës, ka qenë në gradën 7-të dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me nenin 5 të kontratës së punës dhe dispozitën e nenit 55 par. 1 të Ligjit të punës (Gazeta zyrtare 03-L-212 – të RK), ku është përcaktuar se i punësuar ka të drejtën e pagë e cila caktohet me kontratë të punës në pajtim me këtë Ligj, me kontratën kolektive dhe me aktin e brendshëm të punëdhënësit

Kërkesa e aksionarit - Qeverisë së Republikës së Kosovës – Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik kishte të bënte me koordinimin e nivelit të përgjithshëm të shpenzimeve operative vjetore në përputhje me parametrat e lejuar. Rekomandimi i Ministrisë lidhur me uljen e shpenzimeve operative tek e paditura në raport me të hyrat e përgjithshme, nuk mund të jetë bazë ligjore për uljen e pagës së paditësit, pasi që në rekomandim nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative duhen ulur, e as bëhet fjalë për ulje të pagave, ndërsa e paditura është dashur ta paraqiste një plan të detajuar operativ ku do të përcaktohej se cilat shpenzime mund të reduktohen dhe me çfarë përfshirje do të duhej të ishte reduktimi, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur. Përveç kësaj, në shkresat e lëndës nuk ka prova se e paditura ka bërë ndërhyrje në aktet normative të saj lidhur me uljen e gradave të punonjësve të saj dhe as prova të tjera nga të cilat do të rezultonte arsyeshmëria për nxjerrjen e vendimit për uljen e pagës së paditësit. Për arsyet e cekura si dhe të dhënat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, kjo Gjykatë i cilësoi si të pabazuara thëniet e parashtruara në revizion se aktgjykimet e të dy gjykatave janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Parashtrimet në revizion se e paditura ka vepruar në kuadër të qëndrimeve dhe vendimeve të marra nga aksionari i vet - Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ka bërë nivelizimin e pagave në pajtim me vendimin e ligjshëm të këtij organi, kjo Gjykatë i vlerësoi si të papranueshme për faktin se vendimi i Bordit menaxhues nuk përmban referenca ligjore dhe bazë të vlefshme juridike për marrjen e një vendimi më të favorshëm për të paditurën, ashtu siç pa bazë theksohet në revizion.

Qëndron fakti se, në raste tjera të ngjashme, kolegje të ndryshme të gjykatës së shkallës së dytë kanë marrë vendime të ndryshme, mirëpo secili aktgjykim i gjykatës së shkallës së dytë mundë t'i nënshtrohet në mënyrë të veçantë procedurës sipas revizionit dhe në këtë mënyrë, përmes vendimit gjyqësor të gjykatës së revizionit, mënjanohet vendimmarrja e ndryshme e gjykatës së shkallës së dytë për situata të njëjta.

Parashtrimet në revizion se aktgjykimet e të dy gjykatave janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara nga dispozita e nenit 182 par 2 pika (n) të LPK, lidhur me dispozitën e nenit 190.2 të LPK, përkatësisht nenit 191.1 të LPK, kjo Gjykatë i vlerësoi si të paqëndrueshme për faktin se aktgjykimet e të dy gjykatave, në pjesën e parë të dispozitivit, nuk janë përfshirë nga këto shkelje; dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm dhe nuk është në kundërshtim me arsyetimin, ndërsa të dy gjykatat kanë vlerësuar faktet relevante për vendosjen e drejtë të kësaj çështjeje juridike dhe përmbajnë arsye faktike dhe juridike për të gjitha faktet relevante, që janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë .

Parashtrimet në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë nga shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara nga dispozita e nenit 204 të LPK, pasi që nuk janë vlerësuar pretendimet në ankesë lidhur me afatshmërinë e padisë, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nuk përmbajnë një bazë të vlefshme juridike për marrjen e një vendimi më të favorshëm për të paditurin për faktin se kërkesa kryesore e paditësit është realizimi i të drejtës së diferencës së pagës dhe në këtë rast paditësi nuk është vonuar me paraqitjen e padisë nga se kontesti kryesisht ka të bëjë me pagesën e diferencës së pagës për shkak të një vendimi arbitrar të kundërligjshëm të së paditurës për ulje të saj, për të cilën kërkesë, në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, afati i parashkrimit është 3 vjet, pra afati i paraqitjes së padisë nuk mund të llogaritet, siç pretendohet pa bazë në revizion, në pajtim me nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës.

Parashtrimet tjera në revizion kanë të bëjnë me konstatimin faktik dhe qëndrimet juridike të dy gjykatave, prandaj, si të tilla, ato nuk mund të kenë ndikim për vendimmarrje në meritum të çështjes.

Aktgjykimet e lartpërmendura, në pjesën aprovuese me të cilën detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë ndryshimin e pagës, bonusit të trustit mes gradës 7 dhe 6, përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, parashikuar nga neni 182.2 pika (n) të LPK. Në fakt, aktgjykimi i shkallës së parë, si i tillë, është i paqarët në dispozitiv dhe në kundërshtim me arsyetimin e dhënë, pasi që në dispozitiv nuk është përcaktuar shuma e këtij ndryshimi të pagës, ndryshimi i bonusit dhe trustit mes këtyre gradave, që duhet të paguajë e paditura. Një aktgjykim i tillë nuk mund të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme. Edhe kërkesëpadia në këtë drejtim ka qenë e parregullt. Për shkak të këtyre shkeljeve thelbësor procedurale, gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht.

Në rigjykim, lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadiës, pala paditëse duhet të thirret për ta bërë saktësimin e kërkesëpadiës dhe, pas kësaj, të vërtetohet shuma e ndryshimit të pagës, bonusit dhe të trustit mes këtyre gradave, kështu që, pas administrimit edhe të provave të tjera që ndodhen në shkresat e lëndës dhe vlerësimit të drejtë të tyre, për këtë çështje të merret një vendim i ligjshëm.

Për arsyet e mësipërme dhe në pajtim me nenin 222 lidhur me nenin 223.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr. 81/2016, më 15 prill 2016

Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani